

**UDHËZIM**  
**Nr.394/4, datë 11.11.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.308, DATË 8.5.2009 “PËR PAJISJEN ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË SHTETASVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, të ndryshuar, të nenit 6 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar dhe ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”,

Me qëllim unifikimin dhe standardizimin e procedurave që ndiqen nga zyrat e gjendjes civile, kompania “ALEAT”, strukturat e Policisë së Shtetit, për pajisjen e shtetasve me pasaportë biometrike, në funksion të parandalimit të veprimtarisë kriminale që lidhet me falsifikimin, shpërdorimin e detyrës etj., dhe të vënies para përgjegjësisë ligjore të personave përgjegjës,

**UDHËZOJ:**

Pas pikës 2 të udhëzimit nr.308, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“Shtetasit shqiptarë, që aplikojnë për pasaportë biometrike për çdo herë, duhet të pajisen me formular identifikimi me fotografi nga komisarati i policisë ku kanë vendbanimin, i cili plotësohet në dy kopje. Formulari i identifikimit miratohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Kopje e formularit të plotësuar dhe të verifikuar nga policia i paraqitet punonjësit të gjendjes civile pranë zyrës së aplikimit. Kopja e këtij formulari bëhet pjesë e dokumentacionit shkresor sipas pikës 2 të këtij udhëzimi.”

Pas pikës 16 shtohet:

Udhëzimi nr.394, datë 3.11.2011 “Mbi procedurat e pajisjes me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BRENDSHËM**  
**Bujar Nishani**